



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.32, datë 20/09/2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “KËRKESË PËR KRYERJE SHPIMI  
NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI)”  
SUBJEKTIT “FUSHË-KRUJË CEMENT FACTORY” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi) për qëllime teknologjike, subjektit “Fushë-Krujë Cement Factory” sh.p.k, me vendndodhje “Ura e Gjolës”, bashkia Fushë-Krujë sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin

- X= 475075.6
- Y= 4592634.0

- Z=22 m.m.n.d

Prurja e kërkuar:  $Q = 30$  l/sek.

- Thellësia e parashikuar =75 m
- Diametri 1 (mm) 650 - Thellësia nga 0.00 m në 3.0 m
- Diametri 2 (mm) 508 - Thellësia nga 3.0 m në 75 m

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

